

Eficienca e buxhetit të Bashkisë Këlcyrë (Viti 2019)

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2019

Studimi ka për qëllim të analizojë eficiencën dhe shpenzimet e të ardhurave për vitin 2019, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.

Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.

Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.


Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve, /000 lek

Burimet e financimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	81,385	790,146	38%
Transferta e kushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	72,000	699,029	33%
Transferta e pakushtëzuar sektoriale (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	34,710	336,990	16%
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	26,055	252,961	12%
Të ardhura të tjera (të ardhura nga institucionet që Bashkia ka nën varësinë e saj)	1,200	20,388	1%
TOTALI	216,250	2,099,515	100%

Burimi: Bashkia Këlcyrë (llogaritje EIC)

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Këlcyrë 2019



Burimi: Bashkia Këlcyrë (llogaritje EIC)

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Këlcyrë për vitin fiskal 2019

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2019. Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

Tabela 2. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale

Emërtimi i shpenzimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore	85,050	825,728	39
Shpenzime Korrente	131,200	1,273,786	61
Shpenzime për Investime	-	-	0
TOTALI	216,250	2,099,515	100


Burimi: Bashkia Këlcyrë (llogaritje EIC)

Figura 2. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale



Burimi: Bashkia Këlcyrë (llogaritje EIC)

Figura 3. Shpenzimet për paga/sig. shoqërore si raport mbi të ardhurat lokale



Burimi: Bashkia Këlcyrë (llogaritje EIC)